Kronikë

Paralajmërim apo tentativë e dështuar vrasjeje natën e vitit të ri? I vihet për herë të dytë tritoli shtëpisë së Altin Lamçes në Lushnje! Shpëtojnë 5 anëtarët e familjes

Nata e ndërrimit e të viteve nuk do të harrohet lehtë për familjen e Altin Lamçes, kjo jo për shkak të atmosferës festive, por sepse sot i është vënë për herë të dytë tritol në banesë. Për fat të mirë, nga shpërthimi nuk ka pasur persona të lënduar, ndonëse në ato momente kanë qenë 5 anëtarët e familjes në shtëpi.

HOROSKOPI

Redaksia
31 Dhjetor 2022, 19:19 | **Përditesimi: 31 Dhjetor 2022, 19:45**

LUSHNJË- Nata e ndërrimit e të viteve nuk do të harrohet lehtë për familjen e Altin Lamçes, kjo jo për shkak të atmosferës festive, por sepse sot i është vënë për herë të dytë tritol në banesë. Për fat të mirë, nga shpërthimi nuk ka pasur persona të lënduar, ndonëse në ato momente kanë qenë 5 anëtarët e familjes në shtëpi. Tritoli ishte vendosur në banesën e vjehrrës së tij, Resmije Turku, aty ku Altin Lamçe jeton së bashku me bashkëshorten dhe 2 fëmijët.

Kjo nuk është hera e parë që i vihet tritoli në banesë familjes Lamçe. Hera e parë ka qenë vetëm 2 muaj më parë, në ***1 nëntor 2022***, ku iu vu tritoli në oborr ku pati dëmtime makina e parkuar dhe u thyen xamat e shtëpisë. Lamçe ka 2 vëllezër në Angli, njëri prej të cilëve me precedent penal dhe kjo është një nga pistat kryesore ku po heton grupi hetimor.

LEXO EDHE:
Shkrumbimi i autobusit në Lushnjë, këto janë pamjet e momentit kur mjeti shpërthen në flakë në mes të rrugës

"Rreth orës 18:30, në lagjen "18 Tetori", Lushnjë, pranë banesës së shtetases R. T, ka shpërthyer një sasi e vogël lëndë plasëse. Si pasojë janë shkaktuar dëme materiale në dy automjetet e parkuara. Menjëherë në vendngjarje kanë shkuar forcat e Policisë dhe grupi hetimor, për të kryer veprimet për sqarimin e rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorit/ve.

Nuk dihet se kush janë autorët, e ndërsa Policia po punon për zbardhjen e kësaj ngjarjeje, nëse ishte një paralajmërim, një tentativë e dështuar vrasjeje apo motive të tjera që ende nuk dihen.

B.K./Shqiptarja.com

TAG: Fier | lushnje | altin lamce | shperthim tritoli

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Mendoni se viti 2023 do të jetë më i mirë në aspektin ekonomik?
Po | Jo | nuk di

Lajme të tjera

Shkrumbohet plotësisht autobusi i linjës Tiranë-Skapar! Shoferi nxjerr jashtë udhëtarët dhe bagazhet e tyre! Flakët u shkaktuan nga defekti në motor (VIDEO)
1 Janar, 16:01

Çifti nga Fieri pret vitin 2023 me gëzim të madh në familje! Vjen në jetë fëmija i tretë, është vajzë
1 Janar, 08:24



Ora shënon 00:00! Fieri feston me super atmosferë (VIDEO)
1 Janar, 00:14

Dyfishohet çmimi i gjelit të detit para festës së Vitit të Ri, qytetarët në Fier: Nuk e marrim dot, shumë shtrenjtë
31 Dhjetor 2022, 15:57

Dhunë fizike në një familje! 53-vjeçarja rreh motrën, mbesën dhe kunatën në Lushnjë, arrestohet nga policia
31 Dhjetor 2022, 11:26

Kompania Bankers Petroleum dhuron 150 pako ushqimore për familjet në nevojë në rajonin e Fierit
29 Dhjetor 2022, 16:36

Vdekja e 48 vjeçares brenda bashkisë së Lushnjës, Berisha: Debatoi me bashkëshorten e deputetit socialist, policët e nxorrën jashtë me dhunë
29 Dhjetor 2022, 13:02



Shkoi në bashkinë Lushnjë për ndihmë ekonomike, vdes në zyrën e kryetares 48-vjeçarja! Sefa: Merrte pagesë KEMP-i, donte mbështetje për babanë
29 Dhjetor 2022, 11:00

Dëmtimi i rrugës dhe urës që lidh 10 fshatra me qytetin e Fierit, banorët: Rrezikohen jetë njerëzish, një dridhje timoni i hedh fëmijët në kanal
28 Dhjetor 2022, 10:04

Sherr në një fast-food në Lushnjë, kamarieri goditet me thikë nga një 66-vjeçar
27 Dhjetor 2022, 13:50

Shqipëria përfshihet nga atmosfera e festës, besimtarët e krishterë në të gjithë vendin kremtojnë Krishtlindjen
25 Dhjetor 2022, 10:22

Kërkoi lekë në këmbim të mos vendosjes së gjobës, Rrumbullaku përjashton nga radhës e policisë efektivin e 'Rrugores' (EMRI)
25 Dhjetor 2022, 07:27

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje